




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE  
MUNICIPALITY OF GJILAN  
GILAN BELEDIYESI

## Njësia e Prokurimit

Gjilan, me datë: 28.07.203

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjilanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të dt. **26.07.2023** të parashtruara nga: *Operatori Ekonomik "Kompania e Sigurimeve Eurosig "S.H.A nga Prishtina*, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "*Sigurimi i automjeteve te Komunës me Nr. i prokurimit 651-23-7056-2-2-1 dhe Nr i brendshëm 651 23 051 221* nxjerr:

### V E N D I M

1. **Refuzohet** - kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomikë "*Kompania e Sigurimeve Eurosig "S.H.A nga Prishtina*, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "*Sigurimi i automjeteve të Komunës me Nr. i prokurimit 651-23-7056-2-2-1 dhe Nr. i brendshëm-651 23 051 221* e dt. **26.07.2023** kundër Njoftimit për publikim të datës **14.07.2023** Autoritetit Kontraktues të datës **29.06.2023** të publikuar në platformën e prokurimit elektronik.
2. **AK - Komuna e Gjilanit vendosë të vazhdojë sipas Dosjes së Tenderit dhe Njoftimit për Kontrate të datës 14.07.2023.**
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <http://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### A r s y e t i m

*Operatori Ekonomik "Kompania e Sigurimeve Eurosig "S.H.A nga Prishtina* me datë **26.07.2023**, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, , lidhur me aktivitetin e prokurimit për Sigurimin e automjeteve ne Komunen e Gjilanit Publikimit me titull: "*Sigurimeve i automjeteve ne Komunen e Gjilanit - sipas njoftimit per kontrate te publikuar në Gjilan me nr. referues 651-23-7056-2-2-*. Autoriteti Kontraktues me datë **28.07.2023** ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës për rishqyrtim të parashtruar nga "Kompania e Sigurimeve Eurosig" S.H.A, Autoriteti Kontraktuese -Kuvendi Komunal Gjilan ka konstatuar se pretendimet e juaja janë të pa bazuara në lidhje me pretendimet e juaja

Pretendimet :

Po iu drejtohem në lidhje me aktivitetin e prokurimit Sigurimi i automjeteve të Komunës me numër të prokurimit 651-23-7056-2-2-1 dhe numër të brendshëm 651 23 051 221.

Ju njoftojmë që industria e sigurime jo-jete e ne veçanti kategoria e sigurimit të automjeteve TPL është nën mbikëqyrje të plote nga ana e Bankës Qendrore të Kosovës. Gjithashtu për dijeninë tuaj ju njoftojmë që me rastin e licencimit të kompanive të sigurimit që kanë të drejtë të operimit në Republikën e Kosovës Banka Qendrore miraton tarifat e sigurimit TPL të cilat janë të pandryshuara dhe janë të monitoruara në mënyrë të vazhdueshme nga Banka Qendrore e Kosovës.

Ju njoftojmë që e gjithë industria e sigurimeve Jo-Jete mbikëqyret nga Banka Qendrore e Kosovës dhe si e tillë e bën miratimin e tarifave. Për më tepër tarifat janë UNIKE vetëm në tre Grupe tarifore si me poshtë: "Grupi Tarifor I, Cm3 - Automjete për pasagjer" "Grupi Tarifor II, Ton - Automjetet Kargo-Kamionet "Grupi Tarifor III, KW - Autobusët Urban" dhe "Grupi Tarifor III, KW - Autobusët Ndërrurban" Ndërsa Grupet tarifore që kanë tarifa të ndryshme janë: "Grupi Tarifor IV, - Traktorët me rexhistrim të detyrueshëm " "Grupi Tarifor V, - Motoçikletat" "Grupi Tarifor VI, - Rëmorkiot".

Tek specifikimi teknik i shfaqur nga ju kemi vënë re që të gjithë flotën tuaj e keni përfshirë në një LOT të vetëm me crast Grupi Tarifor V e favorizon Kompaninë e fundit që është licencuar me se voni në industrinë e sigurimeve e cili i ka tarifat me të ulëta në industri me c 'rast behet një diskriminim ndaj të gjithë palëve të interesuara e ne veçanti mbi kompanitë që operojnë mbi 15 vite në industrinë e sigurimeve jo-jete dhe fituesi i këtij aktiviteti të prokurimit është I paracaktuar.

Për të mbështetur këtë që po e sqarojmë me sipër të bashkëngjitur gjeni linkun me të gjithë tarifat e aprovuara nga Banka Qendrore e Kosovës <https://bqk-kos.org/mbikeqyrja-financiare2/mbikeqyrja-esigurimeve/tarifat-dhe-buletini-statistikor/>

Në mënyrë që të shtohet konkurrenca dhe të këtë trajtim të barabartë ndaj të gjithë operatoreve në mirësjellje kërkojmë nga ju ta rishqyrtoni këtë aktivitet të prokurimit duke dhënë dy propozime si më poshtë:

1. Të ndahet në dy LOT-e ky aktivitet I prokurimit Grupe tarifore (I, II dhe III) që kanë tarifa të njëjta të vendosen në një LOT dhe 3 Grupe tarifore (IV, V dhe VI) të vendosen në një LOT tjetër.

2. Të shtohen në këtë aktivitet të prokurimit duke mos ndare në LOT-e edhe një ose disa automjete për Sigurim Kasko me crast do të hapet konkurrenca dhe do kishte trajtim të barabartë ndaj të gjithë Operatoreve e ne veçanti mos të paralizohen Kompanitë e Sigurimeve që operojnë në treg mbi 15 vite të cilat e kanë të pamundur ta bëjnë një ndryshim të tarifave (grupi tarifor IV, V dhe VI).

Mendojmë që kjo është e vetmja mundësi që lejon trajtim të barabartë ndaj të gjithë Operatoreve Ekonomik dhe do krijoj konkurrenca në këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën përdorimi i kriterit të dhënies Çmimi me i ulët është i paarsyeshëm për këtë aktivitet të prokurimit për faktin që fituesi i këtij aktiviteti dihet para fillimit hapjes së ofertave.

Po e citoj Nenin 7 të LPP Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVË I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 pika 1, 2 dhe 3.

Bazuar në këto konstatime që tek Automjetet e Administratës pika 15 "SKUTER" bën diskriminim të dukshëm ndaj OE pale interesi për këtë aktivitet të prokurimit

prandaj si e tillë kërkojmë nga ju të konsideroni si të BAZUAR në tërësi këtë kërkesë për ri-shqyrtim dhe të bëj korigjimin e Dosjes së Tenderit dhe duke hapur mundësi të barabarta për të gjithë Operatorët Ekonomik dhe duke shtuar konkurrencën për të gjithë palët e interesuara për këtë aktivitet të prokurimit. Shpresojmë që nuk do kemi nevojë që rastin ta procedojmë tek organet kompetente siç janë Organi Shqyrtues i Prokurimit dhe organet tjera mbikëqyrëse.

Autoriteti Kontraktues me datë **28.07.2023** ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:  
Sipas pretendimit tuaj ankimor se: AK Komuna e Gjilanit – departamenti i Prokurimit gjatë ushtrimit/  
udhëheqjes së procedurave të prokurimit për këtë lëndë përmes marrjes së vendimit:

**Përgjigjia e AK lidhur me këto pretendim është se:**

**Duke parë pretendimet tuaja Ankimore ne si AK kemi shqyrtuar në detaj këto të fundit :**

**Ne si AK – Autoritet Kontraktues , Komuna Gjilan duke u bazuar në DT si dhe në Njoftimin për Kontratë si dhe Rreth parashtrimit të Kërkesës për Rishqyrtim nga ana juaj Ju informojmë se është e drejtë e AK-se që të vendos kërkesat me të cilat mendon se janë më të sakta dhe të sigurta dhe AK e ka vlerësuar se për këtë pikë nuk ka nevojë të ndahet ne lote dhe AK vazhdon sipas njoftimit të publikuar dhe DT te datës 14.07.2023**

**Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.**

**Këshilla juridike:**

**Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit te Komunës;  
Te gjitha palëve te interesuara;  
Arkivit të Komunës.

**Kujtim Bajram**  
  
**Zyrtar Përgjegjës i zyrës së Prokurimit**  
